Kronikë

Ishte në kërkim për vjedhje me dhunë, arrestohet 31 vjeçari, qarkullonte me armë në makinën luksoze! Në pranga edhe shoku që e shoqëronte

Jurgen Zotaj, 31 vjeçari që qarkullonte me armë zjarri pistoletë në automjet ndërkohë që ishte në kërkim për vjedhje me dhunë, kapet në flagrancë dhe vihet në pranga. Edhe pasagjeri në këtë automjet, shtetasi Ermal Binjaku, është arrestuar për moskallëzim krimi.



Makina dhe arma që u sekuestruan

[Sh].com Redaksia
6 Korrik, 09:53 | **Përditesimi: 6 Korrik, 11:17**

VLORË- Jurgen Zotaj, 31 vjeçari që qarkullonte me armë zjarri pistoletë në automjet ndërkohë që ishte në kërkim për vjedhje me dhunë, është kapur në flagrancë dhe është vënë në pranga. Edhe pasagjeri në këtë automjet, Ermal Binjaku, është arrestuar për moskallëzim krimi.

Policia sekuestroi armën e zjarrit pistoletë me municion luftarak dhe automjetin luksoz tip 'Range Rover' që drejtonte 31-vjeçari.

[Sh].com

LEXO EDHE:
VIDEO/ 'Shpërthen' në zjarr makina në Llogara, merr flakë edhe rruga

> *"Shërbimet e Delta Force, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Vlorë, në vijim të punës për goditjen e paligjshmërisë në fushën e armëmbajtjes pa leje, bazuar dhe në inteligjencën informative për dy shtetas që po qarkullonin në fshatin Kotë me automjet dhe dyshoheshin se ishin të armatosur dhe mund të kryenin ndonjë veprimtari kriminale, menjëherë kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Outside", si rezultat i të cilit u arrestuan në flagrancë shtetasit:*
>
> *- Jurgen Zotaj, 31 vjeç, banues në Vlorë, për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit";*
>
> *- Ermal Binjaku, 34 vjeç, banues në Tiranë, për veprën penale "Moskallëzimi i krimit", njoftoi policia.*

Në vendin e quajtur "Fusha e Murrës", në fshatin Kot, shërbimet e Policisë kanë ndaluar automjetin dhe gjatë kontrollit fizik, 31-vjeçarit iu gjet një armë zjarri pistoletë me krehër dhe municion luftarak, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, bashkë me automjetin.

Nga verifikimet e mëtejshme rezultoi se ishte i shpallur në kërkim pasi Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lushnjë, me vendimin e datës 17.11.2022, i ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprën penale" "Vjedhja me dhunë", kryer në bashkëpunim.

Materialet i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme procedurale.

A.M./Shqiptarja.com

TAG: ermal binjaku | jurgen zotaj | Vlore

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.com

Sondazhi i ditës:
5 vite punë e detyruar në Shqipëri per studentët e Mjekësisë, Jeni dakord?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

U bllokuan në shkëmbinjtë e Gjirit të Filikurit, shpëtohen 2 turistët amerikanë që shkuan me mjet lundrues për eksplorim
5 Korrik, 21:56



Humbën rrugën në Karaburun, shpëtohen 5 turistët e huaj
5 Korrik, 20:24



Zyrtare/ Eni Imami lë Superligën për Flamurtarin, në Vlorë firmos edhe një sulmues
5 Korrik, 16:31

Më 14 korrik nis festivali i 'Porto Palermos', 5 fundjava magjike në kalanë e Ali Pashës me Olen Cesarin e artistë të jashtëzakonshëm
5 Korrik, 14:10

U rrëmbye për një javë, pas denoncimit të prindërve në 'Pa Gjurmë', lirohet 37-vjeçarja: Abuzuan seksualisht, më kyçën në një banesë në Vlorë
4 Korrik, 17:46

Tentoi të vrasë me thikë 65-vjeçarin në Vlorë, arrestohet Fatjon Kocaj! Në pranga edhe një i ri që plagosi kunatin
4 Korrik, 13:10

Ministrja e Bujqësisë vizitë në Itali, Krifca: Së shpejti inkubatorë për përpunimin e peshkut dhe frutave në Vlorë dhe Korçë
4 Korrik, 12:50

E rëndë në Vlorë, 40-vjeçari godet me thikë kunatin e tij, shoqërohet në policë! I plagosuri jashtë rrezikut për jetën (EMRI)
3 Korrik, 14:22

Himarë, shpërndanin drogë në lokale nate, në pranga 2 të rinjtë nga Borshi
3 Korrik, 11:32

Fshehu 16 mijë euro të padeklaruara në mjet, nën hetim 37-vjeçari në Portin e Vlorës
3 Korrik, 10:17

Shfrytëzonin për të lypur katër fëmijët e mitur, vihen nën hetim dy gra në Sarandë
2 Korrik, 16:49

Sekuestrohen 16 mijë euro të padeklaruara në Portin e Vlorës, paratë ishin fshehur në furgonin që vinte nga Brindisi
2 Korrik, 15:22

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Getbutton

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje